



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

PROJEKT VENDIM

NR. __, DATË __/__/2025

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 400 703.84 (KATËRQINDMIJË E SHTATËQIND E TRE, PIKË TETËDHJETË E KATËR) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: "RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM"

Në mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9, pika 1.2/b të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, sipas relacionit të ardhur nga Drejtoria Ligjore, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 400 703.84 (katërqindmijë e shtatëqind e tre, pikë tetëdhjetë e katër) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraparak, dhe është pjesë e këtij vendimit, që preken nga investimi publik me objekt: "Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm".
2. Fondi i shpronësimit me vlerë 400 703.84 (katërqind mijë e shtatëqind e tre, pikë tetëdhjetë e katër) lekë të parashikohet në buxhetin e vitit 2025. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtore

Alcinda Rroshi

KRYETAR

Emiriana Sako

BASHKIA Durrës

LISTA PARAPIRAKE E PRONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI: RIKONSTRUKSIONI RRUGA ISHIEM

PRONARI				TE DHËNA DITORE										VLERSIMET PËR SHPRONËSIMIN SIPAS LLOJIT TË PASURISË		
Nr.	Emër	Adesi	Mbitembër	Z.K.	Nr. Pas.	Lloji pas.	Sip. Tot.	Truall	Arë	Ndërtose	Volum	Page	Sip. (m ²)	Cmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Shënime
1	Gjok	Lazer	Lazer	1522	156/53	Are	4134		PO		1	187	142.34	320	45548.8	
2	Miftar		Lumeshi	1522	154/2	Are	4717		PO		1	184	44.77	320	14326.4	
3	Alfred Murgu		Lazer	1522	156/07	Are	915		PO		4	160	13.07	320	4182.4	
4	Agon		Bara	1522	156/03	Are	600		PO		4	165	160.19	320	51260.8	
5	Insula 6 vlezesh shpik			1522	153/40	Are	12528		PO		7	170	359.94	320	115180.8	
6	Murati Group 012			1522	153/39	Are	2098		PO		8	219	11.1	320	3552	
7	Zef	Jak	Canaj	1522	153/38	Are	1180		PO		5	182	29.38	320	9401.6	
8	Elton	Bahir	Nuri	1522	156/163	Truall	166.66	PO			6	109	44.96	339	15241.44	
9	Dritan		Ismaku	1522	156/164	Are	166.67		PO		6	110	27.49	320	8796.8	
10	Muharran		Kapelli	1522	148/5	Are	564		PO		3	57	69.84	320	22348.8	
11	Shua			1522	148	KENETE	6100		KENETE		2	230	1136.86	0	0	
12	Mikel Edira		Raci	1522	147/91	Are	500		PO		4	121	27.08	320	8665.6	
13	Artur	Gjergj	Musa	1522	156/176	Are	500		PO		7	183	86.76	320	27763.2	
14	Miranda Doran	Perparim	Bonaj	1522	147/136	Are	1004		PO		7	194	102.32	320	61542.4	
15	Tomorr	Seni	Simoni	1522	147/46	Are	500		PO		3	117	28.03	320	9257.6	
16	Abdulla		Hoxha	1522	147/24	Are	360		PO		3	20	11.36	320	3635.2	

TOTALI

2386.39 m2

400703.84

(katerqind mije e shateqind e tre pike tetedhete e kater lek)

Grupi i Punës:

Ilir Kaculi
Aleks Prenga
Jemir Kuri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

RELACION

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 400 703.84 (KATËRQIND MIJË E SHATËQIND E TRE, PIKË TETËDHJETË E KATËR) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: "RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM"

PARA KËSHILLIT BASHKIAK

K ë t u

Të nderuar këshilltarë!

Projekt vendimi që po ju paraqesim për shqyrtim, ka për qëllim miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 400 703.84 (katërqind mijë e shatëqind e tre, pikë tetëdhjetë e katër) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken nga investimi publik me objekt: "Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm".

Bëjmë me dije këshilltarët se fondi i sipërshtënuar ka si destinacion pagimin e kundërvlerës së pronarëve, prona e të cilëve është prekur nga investimi publik me emërtimin e mësipërm.

Bazuar në ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, bashkia ushtron dhe kompetenca që ka të bëjë me infrastrukturën dhe shërbimet publike, ku neni 23 i ligjit "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike", përcakton se: "... Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për ... Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore...."

Duke e konsideruar si funksion të vetin, nga ana e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike pranë Bashkisë është hartuar Projekti zbatimi me objekt: "Rikonstruksion Rruge në Njësinë Administrative Ishëm".

Para realizimit të projektit nga ana e strukturave të bashkisë është marrë dhe informacioni nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Durrës, nëse në projektin me emërtimin e mësipërm preken apo zhvlerësohen prona private, kjo si një detyrimi Kushtetues, i sanksionuar në nenin 41 të Tij, si dhe në ligjin e posaçëm të shpronësimit për interes publik, që mban nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, ku Neni 2 përcakton se "... E drejta e shpronësimit dhe e marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private ushtrohet për një interes publik, që nuk mund të realizohet

ose të mbrohet në mënyrë tjetër, veçse për shkaqe dhe në respektim të procedurave të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, në atë masë sa është e domosdoshme për realizimin e qëllimit të shpronësimit dhe në çdo rast kundrejt një shpërblimi të drejtë....". Neni 4 i ligjit përcakton se: "... Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private bëhet duke respektuar dhe kompensuar në vlerë, në përputhje me ligjin, të drejtat e të tretëve mbi pasuritë pronë private që shpronësohen, si dhe zhvlerësimin për shkak të shpronësimit të pasurive të tjera pronë private që nuk janë objekt i shpronësimit....". Neni 8: "Shkaku i shpronësimit", përcakton se: "Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për këto shkaqe: ... Për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës, në shërbim dhe interes të publikut...". Neni 10, "Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese të kërkesës për shpronësim", përcakton:

1. Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë kompetente sipas ligjit, kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion:

- a) Aktet që vërtetojnë cilësinë dhe regjistrimin e tij si person juridik.
- b) Projektet e nevojshme dhe të miratuara sipas ligjit, si dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik, lidhur me realizimin e këtyre projekteve.
- c) Dokumentacioni lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo të zhvlerësimit.
- ç) Vlerësimi paraprak i objekteve të shpronësimit dhe i masës së shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat.
- d) Lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet.
- dh) Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse.
- e) Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës.
- ë) Dokumentet që vërtetojnë shkakun e shpronësimit, sipas nenit 8 të këtij ligji.

Nga ballafaqimi i bërë gjurmës së projektit, vijës së shpronësimit me hartën e përditësuar, ardhur nga ASHK –ja, Durrës, rezulton se nga projekti i bashkisë prek 16 pasuri, nga këto 1 pasuri me gjendje juridike "shtet" dhe 15 pasuri me gjendje juridike "pronë private".

Pasuritë që preken dhe që do të kundërshtëpërblehen është e llojit tokë "Arë" dhe një pasuri është e llojit tokë "Truall". Sipërfaqja e gjithë pasurive që preken, si ato me gjendje juridike shtet dhe ato me gjendje juridike pronë private është 2 386.39 m². Vlera e shpronësimit është 400 703.84 (katërqind mijë e shtatëqind e tre, pikë tetëdhjetë e katër) lekë. Në këtë vlerë nuk përfshihen pasuritë me gjendje juridike shtet, mbasi vlera e tyre është 0 (zero). Evidentimi i pasurive me

gjendjes juridike “shtet” ka për qëllim vetëm rakordimin me institucionet shtetërore apo publike, që i kanë në pronësi apo administrim këto pasuri, me qëllimin për të kryer veprimet në kontabilitet. Pra, pasuritë me gjendje juridike “shtet” nuk shpronësohen, por për rastin kur kërkuesi është institucion shtetëror apo publik këto pasuri pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, kalojnë në favor të investitorit, pa kundërshtim, dhe vlera e këtyre pasurive është 0 (zero).

Pas marrjes së Vendimit nga ana juaj, materiali ligjor e teknik, që bën fjalë për shpronësimin, si dhe Vendimi i pritshëm nga ana juaj, do t’i përcillet Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit, kjo sipas përcaktimit të VKM-së nr. 395, datë 13.05.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”.

Pjesë e këtij relacioni janë dhe aktet e mëposhtme:

1. Urdhrit nr. 158, datë 14.5.2024, “Për ngritjen e grupit të punës, për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga investimi publik me objekt: “Rikonstrukcion rruge në Njësinë Administrative Ishëm”.
2. Projekti zbatimi, i hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.
3. Kërkesë drejtuar Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike pranë Bashkisë, që mban nr. 2221 prot., datë 13.02.2025, për vënien në dispozicion të projektit përfundimtar me emërtimin: “Rikonstrukcion Rruge në Njësinë Administrative Ishëm”.
4. Shkresë nr. 2221/1 prot., datë 13.02.2025, dalë nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike me lëndë: “Kthim përgjigje suajës nr. 2221 prot., datë 13.02.2025”, ku i bashkëlidhet projekti me emërtimin: “Rikonstrukcion i Rugës “Bregu i Detit”, Lalëz, Ishëm”, miratuar me Leje infrastrukture nr. 660-24/4, datë 30.10.2024 (12 fletë); Leje Infrastrukture nr. 660-24/4, datë 30.10.2024 (3 fletë), ku i bashkëlidhen shkresat me nr. 233 prot., datë 16.8.2024, dalë nga OSSH; Konfirmimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit; Konfirmimi i ASHK, Durrës me lende: “Mendim për leje Infrastrukture”; Shkresa nr. 3600 Prot., date 28.8.2024, dalë nga AZHT-ja; Shkresa nr. 660-24/ prot., datë 20.8.2024, dalë nga Drejtoria MZSH, Bashkia Durrës.
5. Përgjigje ardhur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, në rrugë elektronike më email zyrtar, nënshkruar elektronikisht datë 07.02.2025, ku i përgjigjet kërkesës sonë për informacion, për statusin juridik të pasurive që preken nga projekti (kartelë dhe hartë treguese).
6. Vlerësimi paraprak i hartuar nga grupi i punës, shoqëruar me hartë kadastrale.
- 7 Fragment i hartës fizike.
8. Relacion drejtuar kryetares së bashkisë mbi zbatimin e urdhrit nr. 158, datë 14.5.2024, “Për ngritjen e grupit të punës, për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga investimi publik me objekt: “Rikonstrukcion Rruge në Njësinë Administrative Ishëm”.

**SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE DHE
MENAXHIMIT TË ASETEVE**

Pranyera Gagani

